



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2022:225229

Datë: 27.08.2024

Numri i dokumentit: 06089999

P.nr.397/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit F.K., nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.1273/22 të datës 24.10.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, i datës 22.08.2024, në praninë e prokurores së shtetit Vyrtyte Gërvalla, të dëmtuarës M.K., përfaqësuesi me autorizim av.A.F., të pandehurit F.K. dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit av.K.B.P., pas shpalljes së aktgjykimit më datë 22.08.2024, më datë 27.08.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: F.K. nga i ati E., e ëma Sh., e vajzërisë V., data e lindjes..., në Vushtrri, me vendbanim në Vushtrri”, i pa punë, i martuar, prind i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer Fakultetin Ekonomik, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, edhe më parë i gjykuar.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Nga data 18.10.2021 deri me datën 15.04.2022 nuk e ka respektuar vendimin e plotfuqishëm të Gjykatës së Republikës së Kosovës, në atë mënyrë që, nuk ka vepruar sipas Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore të Mitrovicës – Dega në Vushtrri P.nr.490/2020 të datës 18.10.2021 dhe nuk i ka paguar ish bashkëshortes shumë e obliguar të alimentacionit për vajzën e tyre të përbashkët S.K., në shumë prej 350 (treqind e pesëdhjetë euro) por ndonjëherë e ka paguar tërë shumën, ndonjëherë i ka kapërcyer pagesat, kurse ndonjëherë i ka paguar shumat të cilat kanë qenë më të vogla nga ato për të cilat ka qenë i detyruar sipas Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës,

- Me këtë ka kryer veprën penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe nenit 393 të KPRK-së, si dhe nenit 364, 449 dhe 462 të KPPK-së, e

G J Y K O N

TË PANDEHURIT: F.K. i shqipton DËNIM MË GJOBË në shumën prej tetëqind (800) euro, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se i pandehuri refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të dëmit të i'a paguaj të dëmtuarës shumën prej njëmijë e tetëqind euro (1800) euro..

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej tridhjetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëqind euro (50€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr. 1273/2022 të datës 24.10.2022, kundër të pandehurit F.K., nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së.

Deklarimi i të pandehurit për pranimin e fajësisë

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më datë 22.08.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, në kuptim të nenit 320 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ofron mundësinë e deklaramit rreth fajësisë, ashtu që i njëjti ka deklaruar se e pranon fajësinë sipas, është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre dhe i premtton gjykatës që do të i përmbushë detyrimet dhe nuk do të përsërisë më vepra penale të kësaj apo natyrës tjetër edhe pse gjendja e tij është shëndetësore është përkeqësuar dhe kjo ka qenë arsyeja e mos përmbushjes së detyrimit. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet fjalën përfundimtare të avokates mbrojtës dhe arsyeja pse nuk e ka takuar vajzën e tij është fakti se ish bashkëshortja e tij ka kërkuar kompensim dëmi në shumën prej 7700 euro dhe më ka ardhur marre nga vajza ime.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se i propozon gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të pandehurit, pasi që i njëjti e ka pranuar fajësinë pasi që është informuar nga gjykata për benefitet dhe pasojat e këtij

instituti si dhe pranimi i fajësisë është në përputhje me të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se duke pasur parasysh që i pandehuri është deklaruar fajtor për këtë vepër penale, i ka propozuar gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit të i ketë parasysh si rrethana rënduese se si rezultat i kësaj vepre penale ka pësuar një e mitur, e cila për shkak të moshës nuk është në gjendje që të të siguroj mjete për ekzistencën e saj, të merret si rrethanë rënduese shkalla e lartë e dashjes në veprimet e të pandehurit për arsyeje se i njëjti për një periudhë kohore ka bërë pagesën sipas aktvendimit të gjykatës pra ka qenë në njohuri për obligimin e tij, ndërsa pastaj për periudhën si në aktakuzë ka ndaluar së paguari detyrimin e tij. Si rrethanë lehtësuese të i merret pranimi i fajësisë i shprehur sot në seancë gjyqësore ndërsa sa i përket propozimit të palës së dëmtuar për kompensim dëmi, këtë propozim e lejmë në vlerësim të gjykatës pasi sipas gjendjes faktike të përshkruar në aktakuzë në periudhën kohore prej 18.10.2021 e deri me 15.04.2022, janë bërë pagesa të pjesshme të detyrimit të tij sipas vendimit të gjykatës, andaj prokurori i shtetit në këtë fazë nuk ka mundësi që të precizoj saktë vlerën e dëmit në rast se pala e dëmtuar paraqet dëshmi të cilat e vërtetojnë shumë konkrete atëherë i propozojmë gjykatës që të aprovoj këtë propozim.

Përfaqësuesi me autorizim i palës së dëmtuar lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se e përkrah fjalën e prokurores së shtetit dhe kërkon kompensimin e dëmit lidhur me këtë çështje penale dhe atë për periudhën sipas aktakuzës nga data 18.10.2021 e gjer me datën 15.04.2022, në shumë prej 1800 euro ndërsa sa i parkete pjesës tjetër do të parashtron padi civile për realizimin e kësaj të drejte. Ndërsa në fjalën përfundimtarë ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e prokurorit të shtetit dhe njëherit gjykatës i dorëzon gjendjen e pagesave të cilat i ka kryer i pandehuri pjesërisht për periudhën nga data 18.10.2021 e deri me datë 15.04.2022, e që vlera e pa paguar sipas përlllogaritjes së tyre arrin shumë prej 1800 euro, e që këtë provë i'a dorëzoj gjykatës ndërsa për pjesën tjetër të pagesave do të parashtron padi civile për realizimin e saj. Gjykatës i propozon që të pandehurin ta shpallë fajtorë dhe ta dënoj sipas ligjit.

E dëmtuara lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e avokatit mbrojtës. Ku e njëjta edhe në fjalën përfundimtare ka mbështetur në tërësi fjalën përfundimtare të avokatit mbrojtës.

Mbrojtësi i të pandehurit me autorizim lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se i propozon gjykatës që të bëj pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i saj, pasi që ky pranim është bërë në mënyrë vullnetarë pas udhëzimit të mjaftueshëm nga gjykata dhe konsultimit nga mbrojtja. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se duke qenë se i mbrojturi i saj e ka pranuar fajësinë për shkak se disa muaj nuk ka arritur të paguaj alimentacionin dhe i njëjti kërkon falje, u pendua, gjithashtu tregoj gatishmërinë që është në gjendje të bëj gjithçka për vajzën e tij por për shkaqe shëndetësore që nuk mund të punoj edhe ka mbetur mbrapa lidhur me financimet. I njëjti ka treguar gatishmëri që të kryej pagesat në shumë prej 150 euro por jo në tërësi. Andaj gjykatës i propozon që të merren parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese të cekura më lartë me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, kurse nuk qëndrojnë rrethanat rënduese të prokurorisë edhe atë shkalla e lartë e dashjes siç citoj prokurorja.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: raporti fillestar i incidentit, i datës 15.04.2022, raporti i oficerit, i datës 15.04.2020, raporti ditor i dhunës në familje, i datës 15.04.2022 procesverbali i marrjes në pyetje për ankuesin M.K., i datës 15.04.2022, procesverbali mbi marrjen në pyetje të dyshuarit F.K., i datës 15.06.2022, qarkullimi për llogarinë bankare.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri ka kryer veprën penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 393 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se *“Kushdo që nuk i bindet ndonjë urdhri, vendimi apo aktgjykimi të plotfuqishëm të ndonjë gjykate në Republikën e Kosovës ose refuzon apo pengon publikimin e vendimit apo aktgjykimit të plotfuqishëm të gjykatës së tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj”*.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69, 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, premtimin që i ka bërë gjykatës se nuk do të përsërisë më vepra penale të kësaj apo natyrës tjetër, si dhe faktin se i pandehuri nuk ka qenë në gjendje të mirë shëndetësore e cila ka ndikuar në mos përmbushjen e detyrimeve, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka gjetur se si pasoj e kësaj vepre penale është dëmtuar një e mitur përkatësisht fëmije i të pandehurit, ko vepër penale është kryer brenda familjes respektivisht ndaj ish bashkëshortes si dhe vajzës si dhe faktin se i njëjti ka qenë edhe më parë i dënuar me aktgjykimin P.nr.124/23 të gjykatës themelore në Mitrovicë dega në Vushtrri dhe me aktgjykimin P.nr.253/2016 të gjykatës themelore në Gjakovë.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana, gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit me gjobë në shumën prej tetëqind (800) euro, ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në

parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike, kompensimin e viktimave të krimit dhe shpenzimet e procedurës

Vendimin lidhur me kompensimin e dëmit ndaj palës së dëmtuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 462 të KPPK-së, në të cilin parashihet se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi.”*, ashtu që në rastin konkret në shqyrtimin gjyqësor me datë 22.08.2024 pala e dëmtuar ka kërkuar për realizimin e kërkesës pasurore – juridike dhe atë për periudhën e përcaktuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.397/22, datë 27.08.2024

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.